



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:031841  
Datë: 23.12.2024  
Numri i dokumentit: 06640524

Pml.nr.640/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Valdete Daka, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, në çështjen penale kundër të dënuarit V. B., për shkak të veprës penale “Marrja e ryshfetit”, nga neni 421, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.30/2023, datë 27.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.664/2023, datë 06.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit V. B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.30/2023, datë 27.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.664/2023, datë 06.09.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimit PKR.nr.30/2023 të datës 27.09.2023, të dënuarit: N. H., L. P. dhe V. B., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Marrja e ryshfetit”, nga neni 421 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka gjykuar secilin veç e veç me dënim me gjobë në shumë prej nga 500 (pesëqind) euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve, në të cilin dënim do t’iu llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, pjesa e mbetur e dënimit me burgim, me kërkesën e të dënuarve, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 2,000 (dymijë) euro, ashtu që iu shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 2,500 (dymijepesëqind) euro, të cilin do ta fillojnë ta paguajnë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, në 4 (katër) këste të barabarta.

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.664/2023, datë 06.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit V. B., dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit V. B., avokati Ymer Huruglica, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, të aprovojë kërkesën, ndërsa të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale dhe të dënuarit t'i shqiptojë një dënim më i ultë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.368/2024, datë 18.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vlerësoi pretendimet nga kërkesa, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të të procedurës penale, sepse këto aktgjykime nuk kanë fare arsyetim në raport me faktet e çështjes që përmban aktakuza, se nuk janë dhënë fare arsye në raport me provat dhe faktet që vërtetojnë se në veprimet e të dënuarit formojnë figurën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe se i dënuari nuk e ka dhe nuk e ka pasur asnjëherë cilësinë e personit zyrtar ose personi i huaj zyrtar apo zyrtari publik i huaj, andaj në veprimet e të njëjtit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Po ashtu, mbrojtja konsideron se edhe vendimi mbi sanksionin penal është shumë i lartë, aq më tepër për faktin se gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, por si të tilla nuk janë marrë parasysh në kuptim të dispozitës së nenit 71 të KPRK-së, sipas së cilës “Gjykata mund të shqipton dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë një dënim më të butë”, veprim këtë të cilin gjykata nuk e ka bërë, përkatësisht nuk e ka aplikuar këtë dispozitë ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, konstatoi se aktgjykimet e kundërshtuara, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me

ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

Duke ju referuar pretendimeve nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar në mënyrë të hollësishme vepra penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari V. B., së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal, pasi që veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha elementet tipike të figurës së veprës penale “Marrja e ryshfetit”, nga neni 421, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën edhe është shpallur fajtor.

Nga kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur këto elemente të figurës së veprës penale dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale dhe se vepra penale ishte kryer me datën 02.02.2023 rreth orës 9:00 minuta, në Gjilan, në atë mënyrë me qëllim që vetit t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, me dashje të drejtpërdrejte janë përfshirë në marrjen e ryshfetit, në atë mënyrë që pasi kandidati M. S., ishte regjistruar dhe kishte mbajtur orët për aftësim në vozitje në auto shkollën “Rinia” në Viti, një ditë para se t’i nënshtrohet testit teorik, në Gjilan takohet me të dënuarin N., me ç’rast edhe arrijnë marrëveshje që me të përfunduar testin teorik kandidati M. S. do t’ia jap 400 (katërqind) euro ryshfet. Pastaj, të nesërmen me datën 02.02.2023, në Gjilan, të dënuarit N.dhe L. në kafeterinë “Federal” takohen me kandidatin M., dhe me automjetin e të dënuarit N., shkojnë në shtëpinë e të dënuarit L., aty kishte qenë duke pritur i dënuari V., i cili ia vendosë kufjet në veshin e djathtë, ndërsa i dënuari L., ia vendosë pajisjet ilegale në trup, e të gjithë së bashku shkojnë tek Qendra e Testimit për patentë shofer, me të hyrë kandidati në test, i dënuari L. përmes pajisjes i tregon për mbushjen e testit, ndërsa me tu vërejtur kandidati nga vëzhguesit lajmërohet policia, me ç’rast pasi kontrollohet gjenden pajisjet e vendosura në trupin e tij.

Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve kryerëse janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari në fjalë.

Në anën tjetër, gjykata e shkallës së parë në arsytimin e aktgjykimit të saj del se ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta për të gjitha pikat e aktgjykimit, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen e arsyeve sa i përket çështjeve të rëndësishme që i referohen veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarit në fjalë, duke pasur parasysh edhe faktin se i dënuari e ka pranuar fajësinë, ndërsa gjykata në fjalë e ka miratuar një pranim të tillë të fajësisë, duke konsideruar se janë përmbushur kushtet ligjore për një gjë të tillë, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes në këtë drejtim janë të pabazuara.

Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se i njëjti nuk e ka cilësinë e personit zyrtar - nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, ngase konform nenit 113, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3

të KPRK-së: “person zyrtar – nënkuptohet personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesat publik”, në të cilën kategori bën pjesë edhe profesioni i instruktorit në auto shkollë, duke e pasur parasysh natyrën subjektit juridik – auto shkollës, si dhe natyrën e funksionit dhe autorizimeve të tij publike, të cilat gjithashtu ndërlidhen edhe me vendosjen në lidhje me të drejtat, obligimet dhe interesave e kandidatëve për të marrë patentë-shoferin.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimin e shqiptuar, përkatësisht faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim i lartë. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së nenit 421, paragrafi 1 të KPRK-së, e cila dispozitë parasheh dënimin me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.

Në faqen e 4-të të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit e po ashtu edhe janë renditur rrethanat lehtësuese të cilat janë marrë për bazë lidhur me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë në seancën e datës 21.09.2023 e ka bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë ishte aprovuar. Me këtë rast, duhet theksuar fakti se pranimi i fajësisë në asnjë rrethanë nuk prejjudikon caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, por e rëndësishme është që i dënuari ka qenë i njoftuar përkitazi me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe atë në prezencë të mbrojtësit të tij.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkuluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.640/2024, më 19.12.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetare e kolegjit  
Mejreme Memaj